

Në BE me:

International Society of Consumer Affairs Officials.

RESPA

ASSEMBLY OF CONSUMER ASSOCIATIONS IN EUROPE

Legjislacioni Kosovar në fushën e mbrojtjes së konsumatorit përfshinë:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, 04/L-121
- Udhëzimin administrativ për etiketën e produkteve ushqimore;
- dhëzimin administrativ për deklaracionin dhe etiketën e mallrave.
- Ligjet dhe aktet tjera nenligjore të zbatueshme në republikën e Kosovës

Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit, nr. 04/L-121

I garanton konsumatorët kosovarë me të njëjta të drejta sikur të legjislacionit evropian për mbrojtjen e konsumatorit.

Informacione të nevojshme

Ju mund të kontaktoni Departamenti për mbrojtjen e konsumatorit, në MTI, për tu ankuar sa here që ju shkelen të drejtat tuaja si Konsumator.

Ju mund të thirrni në çdo kohë, pas orarit dhe gjatë vikendit lene porositë dhe nr. e telefonit apo adresën tuaj.

Konsumatorë.

Ju mund të ankoheni për çdo të drejtë që ju shkellet, pranë DMK-së, Inspektoratit (tregut, sanitar, firo-sanitar) si institucion i ngarkuar për zbatimin e ligjit. Nëse brenda dy javësh nga njoftimi për shkeljen e të drejtës nuk ju zgjidhet problemi juaj, ju mund të drejtoheni gjykatës.

- Ligji për Kontrollin e Duhanit nr. 04-L-156

Ku është e ndaluar pirja (tymosja) e duhanit?

- hapësira publike (të mbyllura)
- hapësira të punës
- mjetet e transportit publik
- hapësirat e përbashkëta të ndërtesave me banesa shumëkatëshe
- hapësira publike të hapura që janë në administrim të institucioneve edukative-arsimore (p.sh. oborre, kopshte etj.)
- afërsi të hyrjeve/daljeve të hapësirave publike (të mbyllura), hyrjeve/daljeve të hapësirës së punës dhe të hyrjeve/daljeve të institucioneve shëndetësore vendet e lojërave për fëmijë, stadium, arenë apo hapësirë për çfarëdo shfaqje

Ju mund të raportoni shkeljen e Ligjit pa pagesë në tel.: 0800-11-000

Adresa:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë Lagja e spitalit
Rr. "Muharrem Fejza" Pn. 10000, - Prishtinë.

Kontakti:

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit
web-faqja: www.mti-ks.org
Tel. pa pagesë nga Vala dhe telefonia fikse 0800 11000



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë / Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

KONSUMATORË: PARA SE TË BLEN GJITHNJË KONTROLLONI!



PËR ANKESA THIRRN

DEPARTAMENTI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT:

PTK
VALA
IPKO

| 080011000

PA PAGESË

Cili është Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit (DMK)

Ky departament funksionon në kuadër të MTI-se. Veprimtaria e këtij Departamenti mbështetet në Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit, ligjet dhe aktet tjera nënligjore si dhe "Programin për mbrojtjen e konsumatoreve 2010-2014".

DMK-ja është përgjegjëse për hartimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorëve dhe harmonizimin e tyre me legjislacionin e BE-së.

DMK jep propozime për plotësimin dhe ndryshimin rregullativ ligjor si dhe nxjerrjen e akteve tjera nënligjore, që janë në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve.

Pranon ankesat e konsumatorëve dhe kërkon nga mekanizmat që janë përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut që ti shqyrtojnë dhe të marrin masat e parapara me ligj.

Bën studimin e funksionimit të tregut dhe rekomandon strukturat e MTI-se për marrjen e masave për funksionimin normal të tregut.

Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit

Këshilli është instrument i rëndësishëm për rregullimin e tregut, mbrojtjen e konsumatorit dhe evitimin e defekteve gjatë shkëmbimit të mallrave në raportin prodhues-tregtar-konsumator.

Këshilli është përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të programit nacional për Mbrojtjen e konsumatorëve i cili përcakton politikën për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhën 2010-2014.

Këshilli përbëhet nga shtatë 7 anëtarë, kryesohet nga përfaqësuesi i MTI-së dhe përbëhet nga përfaqësues të MTI-se, ekspert të pavarur, Shoqatave të Konsumatorëve dhe asociacioneve të biznesit.

Programi Kosovar për Mbrojtjen e Konsumatorëve

Tri objektivat kryesore, të specifikuar në Programin Kosovar për Mbrojtjen e Konsumatorit përfshijnë:

- Krijimin e bazës për zhvillimin e një tregu të sigurt, përfshirë këtu ngritjen e kapaciteteve administrative;
- Mbështetjen e iniciativave të shoqërisë civile për mbrojtjen e konsumatorëve;
- Zhvillimin e sistemit të informimit dhe këshillimit të konsumatorëve.

10 parimet kryesore për mbrojtjen e konsumatorit në Bashkimin Evropian

1. Bli çfarë dëshiron, aty ku ti dëshiron;
2. Nëse malli nuk funksionon, - ktheje;
3. Standarde të larta sigurie për ushqime dhe produkte tjera;
4. Duhet të dish se çfarë je duke ngrënë;
5. Kontrata duhet të jetë e drejtë elementare për konsumatorin;
6. Ndonjëherë konsumatori mund ta ndryshojë mendjen;
7. Krahasimi i çmimeve duhet të jetë i thjeshtë;
8. Konsumatorët nuk duhet të çorientohen;
9. Ju duhet të jeni të mbrojtur kur jeni në pushime;
10. Duhet të ekzistojnë mekanizma efektivë për zgjidhjen e konflikteve në lidhje me produktet e blera jashtë vendit.

DMK bashkëpunon me:

Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit janë:

- Inspektorati qendror i MTI-së,
- Inspektorati Sanitar në AUV.
- Inspektorati veterinar dhe fitosanitar
- Inspektoratet në nivel lokal
- Instituti Kombëtar të Shëndetit Publik,
- Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit,
- Agjencia për Mbrojtjen e Ambientit,
- Shërbimi Doganor.
- Gjykata
- Arbitrazha
- Ombuspersoni

Organizata joqeveritare:

- Shoqatat për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Kosovës,
- Shoqëria civile,
- Oda Ekonomike të Kosovës,
- Aleancën Kosovare të Biznesit,
- Oda Ekonomike Amerikane
- Qendrën Rajonale të Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore, Zyra në Kosovë.
- OJQ-te tjera.

Në Rajon me:

- Drejtorinë e Mbrojtjes së Konsumatorit të Republikës së Shqipërisë,
- Departamentin e Mbrojtjes së Konsumatorit në Maqedoni.
- Zyren për mbrojtjen e konsumatorit në Kroaci
- Zyren për mbrojtjen e konsumatorit në Mal të Zi.